



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 12-4276 /2024

Klinë, datë 07/07/2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.04/2023 për Administrate të Hapur në Komunë, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e draft KAB 2025-2027

- CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projekt dokumentit- Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.
Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. Enver Berisha, Drejtorja e Financave, kryesues;**
 - 1.2. Enver Berisha, Drejtorja e UMM, anëtare;**
 - 1.3. Melihate Behramaj, anëtare;**
 - 1.4. Vlora Tafili, anëtare, si dhe**
 - 1.5. Mirsad Dakaj, anëtare.**
- Grupi punues është përgjegjës për hartimin e draft dokumentit- KAB 2025-2027, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.04/2023 për Administrate të Hapur në Komune, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
- Me rastin e përgatitjes dokumentit në bashkepunim edhe më konsulentët vullnetar, njoftohet kryetari i komunës më qellim te procedimit të tij për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtorja e Financave;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Eleza